

# UDHËZIME TË KËSHILLIT TË EUROPËS PËR IMPLEMENTIMIN E PËRGJEGJSHËM TË SISTEMEVE TË INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË GAZETARI

---

## 1. Vendimi i organeve mediatike dhe gazetarëve për të implementuar sisteme të IA-së

**1.1.** Vendimi për të zbatuar sisteme gazetareske të IA-së nuk duhet të jetë thjesht i drejtuar nga teknologjia ose komercializmi, por edhe i drejtuar nga misioni, në kuptimin që keto sisteme do të ndihmojnë në arritjen e qëllimeve dhe do të përputhen me vlerat e organit mediatik në fjalë. Kjo do të thotë se vendimi duhet të integrohet brenda një vizioni më të gjerë të asaj që organi mediatik shpreson të arrijë, modelit të tij të biznesit, sfidave me të cilat përballlet, rolit demokratik të medias, promovimit të të drejtave të njeriut dhe te etikës profesionale, dhe rolit të teknologjisë në secilën prej këtyre aspekteve.

**1.2.** Vendimi për të zbatuar sisteme gazetareske të IA-së përbën një **vendim editorial** pasi ka rëndësi kritike për realizimin e misionit editorial dhe vlerave profesionale të një organi lajmesh, dhe për këtë arsye duhet që dikush brenda organizatës të jetë qartësisht përgjegjës për zbatimin dhe rezultatet e përdorimit të IA-së gazetareske. Zakonisht, ky duhet të jetë kryeredaktori. Stafi editorial duhet gjithashtu të shqyrtojë dhe të kuptojë se cilat sisteme të IA-së janë në përdorim.

**1.3.** Vendimi për të integruar Inteligjencën Artificiale gazetareske në rrjedhën e zakonshme të punës duhet të udhëhiqet nga detyra ose problemi konkret ndaj të cilit sistemi synon të japë përgjigje.

**1.4.** Kryerja e një **vlerësimi sistematik të rreziqeve** është një parakusht i rëndësishëm për zhvillimin dhe zbatimin e përgjegjshëm të Inteligjencës Artificiale në gazetari. Organizatat e lajmeve duhet të kenë procedura për të njohur, dhe, kur është e mundur, për të vlerësuar dhe zbutur rreziqet që vijnë nga mënyra se si zbatohen sistemet e IA në gazetari, përfshirë cdo rrezik ndaj të drejtave të palëve të treta (si mbrojtja e të dhënave, të drejtat e autorit dhe mosdiskriminimi) si edhe rreziqe ndaj mjedisit, të drejtave të punonjësve të brendshëm dhe të jashtëm, apo të drejtave të subjekteve, mbajtësve të së drejtës së autorit dhe komuniteteve të

prekura. Duhet të pranohet që sigurimi i sistemeve të IA-së mund të mbartë në vetvete rreziqe që lidhen me moskontrollin e plotë mbi të dhënat, metodat dhe proceset.

**1.5.** Vendimi për të zbatuar IA në gazetari duhet, për aq sa lejon struktura përkatëse e organizatës, të jetë një **proces pjesëmarrës** që përfshin dhe balancon interesa dhe perspektiva të ndryshme, duke përfshirë ato të gazetarëve, redaktorëve, zhvilluesve të teknologjisë, pronarëve të produkteve, shërbimeve të marketingut dhe atyre ligjore, reklamuesve dhe audiencës. Vendimi për të zbatuar IA nuk do të merret gjithmonë nga një organizatë individuale lajmesh (filial), por nga organizata mëmë që e zotëron ose e kontrollon atë. Kjo e bën edhe më të rëndësishme vendosjen e procedurave që i bëjnë këto vendime transparente dhe gjithëpërfshirëse, duke mundësuar shprehjen dhe balancimin e interesave dhe perspektivave të ndryshme.

**1.6.** Një aktor i rëndësishëm në këtë proces është **'bartësi i përgjegjësisë'**, të cilit duhet t'i sigurohet një pasqyrë e plotë e gjendjes, si dhe përgjegjësia dhe aftësia për të ndërmjetësuar dhe përkthyer midis aktorëve të ndryshëm të interesit në procesin e vendimmarrjes. 'Bartësi i përgjegjësisë' duhet të ketë një rol në biznesin kryesor të prodhimit të lajmeve, strategjinë e ardhshme, si dhe zbatimin e vetë sistemit (të IA-së). Ndërsa në organizata mediatike më të vogla dhe me burime më të pakta, bartësi i përgjegjësisë mund të mos jetë një rol i veçantë, por i integruar.

**1.7.** Vendimi për të zbatuar sisteme specifike të inteligjencës artificiale në gazetari duhet të bazohet në atë që është ligjërishit dhe teknikisht e realizueshme për t'u automatizuar. Kjo njohuri duhet të përditësohet vazhdimisht për të pasqyruar ndryshimet në kuadrin ligjor, në kapacitetet teknologjike dhe në praktikën e redaksive. Të gjithë ata që kanë rol në procesin e vendimmarrjes duhet të jenë të pajisur me aftësinë, ndjeshmerinë dhe informacionin e nevojshëm, edhe në nivel drejtues, në mënyrë që të marrin vendime të duhura dhe të mirëinformuara. Diskutimi dhe dialogu ndërmjet përdoruesve të inteligjencës artificiale dhe ofruesve të saj janë thelbësorë për ndërtimin e një mirëkuptimi të përbashkët mbi standardet etike dhe të të drejtave të njeriut, si dhe mbi punën, të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella.

**1.8.** Vendimi për të zbatuar sisteme të IA-së duhet të bazohet në testime fillestare ose modele pilot, për të kuptuar më mirë se çfarë është e mundur të realizohet. Kjo përfshin eksperimentimin me mjete dhe ide të reja për të zbuluar mundësi.

**1.9.** Vendimet për zbatimin e një sistemi të inteligjencës artificiale në gazetari nuk duhet të konsiderohen si vendime të vetme dhe të izoluar, por si pjesë e një **procesi ciklik** në kuptimin që ato duhet të bazohen në monitorimin e rregullt të performancës së sistemit të inteligjencës artificiale, kontributit të tij në misionin editorial të organizatës së lajmeve dhe kuadrin ligjor dhe etik të ndryshueshëm në të cilin vepron.

## 2. Identifikimi dhe blerja e sistemeve të IA-së nga organet mediatike dhe përdoruesit profesionistë

**2.1.** Pasi të jenë identifikuar detyrat gazetareske që mund të automatizohen, duhet të merren vendime lidhur me mënyrën e sigurimit të sistemeve të IA-së për gazetarinë. Opsionet përfshijnë **prokurimin** nga një ofrues i teknologjisë së IA-së (që mund të nënkuptojë abonim ose pagesë për akses në një sistem në distancë), ose zhvillimin e tyre brenda institucionit. Zbatimi dhe përdorimi i përgjegjshëm i IA-së në gazetari fillon me prokurimin e përgjegjshëm.

**2.2.** Shumë sisteme të IA-së gazetareske duhet të trajnohen me të dhëna për të funksionuar në mënyrë të dobishme. Për këtë arsye **disponueshmëria, paanësia dhe cilësia e të dhënave** duhet të vlerësohen me rigorozitet. Kur të dhënat lidhen me subjekte (që, sipas përkufizimit të mësipërm, përfshijnë edhe audiencën), **respektimi i rregullave për privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave** është një kërkesë thelbësore, çka kërkon që të zbatohen **masa të përshtatshme për të kundërshtuar paragjykimet, stereotipet dhe diferencimet e tjera të dëmshme**, në mënyrë që këto sisteme të funksionojnë në mënyrë të përgjegjshme. Të dhënat e trajnimit duhet të respektojnë të drejtat e të tjerëve, përfshirë mbajtësit e të drejtave të autorit – gjë që, me evoluimin e sistemeve ligjore, mund të përfshijë, për shembull, kërkimin e pëlqimit dhe ofrimin e skemave të kompensimit. Në disa raste, organizatat e lajmeve do të varen nga ofruesit e teknologjisë për të bërë vlerësime mbi të dhënat, pasi ato nuk janë drejtpërdrejt të përfshira dhe nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë mbi procesin e trajnimit.

**2.3.** Kur zgjidhni një ofrues specifik të teknologjisë së IA-së, është e rëndësishme të merret në konsideratë shkalla në të cilën ofruesi i teknologjisë ka bërë përpjekje për të siguruar përdorimin e përgjegjshëm të të dhënave. Kjo ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në faktin se si sistemi i IA-së gazetareske mund të përdoret në mënyrë të përgjegjshme apo jo.

### 3. Përfshirja e mjeteve të IA-së në praktikën profesionale dhe organizative

**3.1.** Sistemet e IA-së në gazetari kërkojnë si infrastrukturë teknike, ashtu edhe organizative për t'i mbështetur ato. Për këtë arsye, rekomandohet që organizatat e medias ta ndërtojnë dhe ta mirëmbajnë këtë infrastrukturë duke **punësuar** staf të ri ose duke **përmirësuar aftësitë** e stafit ekzistues. Organizatat e lajmeve duhet të **shmangin thjesht zëvendësimin e gazetarëve të trajnuar me staf teknik**. Futja e roleve të lidhura me IA-në nuk duhet të behet në kurriz të zhvillimit të kompetencave bazë të IA-së mes stafit tjetër. Gjithashtu, rekomandohet që në marrjen e vendimeve lidhur me personelin, të merren parasysh me kujdes diversiteti dhe gjithëpërfshirja, duke i kushtuar vëmendje të veçantë përfaqësimit të pakicave, grave dhe grupeve historikisht të marginalizuara, pasi kjo mund të formësojë mënyrën e përdorimit të IA-së dhe rezultatet që ajo prodhon.

**3.2.** Sistemet e IA-së në gazetari mund të përdoren për të kryer detyra me nivel të lartë automatizimi brenda rrjedhave ekzistuese të punës, duke liruar kështu kohë dhe burime për aktivitete të tjera. Megjithatë, edhe për këto detyra – dhe veçanërisht në rastin e automatizimit dhe përdorimit të IA-së gjeneruese – nevojitet **mbikëqyrje editoriale** për të shmangur proceset dhe rezultatet e pasakta ose të njëanshme. Për shembull, tekstet e automatizuara të shkruara mirë dhe që duken të besueshme duhet të kontrollohen me kujdes për pretendime mashtruese, të paplota ose faktikisht të pasakta, dhe identifikimi i tyre kërkon njohuri profesionale dhe mbikëqyrje editoriale. Mbikëqyrja nuk duhet të kufizohet vetëm në kontrollin e rezultateve, por duhet të shtrihet edhe te proceset që i kanë prodhuar ato. Mbikëqyrja editoriale është veçanërisht e rëndësishme për rastet ku rezultatet janë shumë të ndjeshme (p.sh. ato që kanë pasoja konkrete për individët) ose shumë të rëndësishme (p.sh. ato që mund të ndikojnë në shoqëri, siç janë rezultatet e zgjedhjeve), si edhe kur rezultatet prodhohen me ndihmën e inteligjencës artificiale gjeneruese. **Në asnjë rast formalizimi i vlerave profesionale në kod nuk mund të zëvendësojë mbikëqyrjen dhe kontrollin editorial.**

**3.3.** Organizatat e lajmeve duhet të vazhdojnë të kryejnë vlerësime të rrezikut siç përcaktohet në paragrafin 1.4.

**3.4.** **Organet e medias duhet të bëjnë të ditur kur dhe si përdorin sisteme të IA-së**, si për subjektet ashtu edhe për audiencën. Kjo duhet të zbatohet në situatat kur përdorimi i sistemeve të IA-së mund të ndikojë ndjeshëm në të drejtat e subjektit ose të audiencës ose në interpretimin e rezultateve nga audienca. Gjithashtu, brenda organit mediatik duhet të vihet në dispozicion informacion mbi sistemet që janë zbatuar, qëllimin për të cilin janë projektuar, vlerat që ato pasqyrojnë, si dhe masat që po merren për trajnimin e stafit dhe sigurimin e mbikëqyrjes së përshtatshme.

Format e standardizuara të etiketimit që tregojnë se janë përdorur sisteme të IA-së në punën e përditshme do të rrisin dobishmërinë e këtij etiketimi për subjektet dhe audiencën. Përmirësimi i cilësisë së metadata-ve është një mënyrë tjetër për të rritur transparencën dhe përdorimin e përgjegjshëm të sistemeve të IA-së në gazetari.

**3.5.** Puna me sistemet e IA-së në gazetari shpesh kërkon aftësi që shkojnë përtej trajnimit ekzistues të shumicës së gazetarëve. Për këtë arsye, organet mediatike duhet të ofrojnë **trajnim të vazhdueshëm** për stafin (përfshirë drejtuesit ekzekutivë dhe role të tjera relevante) mbi përdorimin e sistemeve të IA-së në gazetari përmes programeve që bashkojnë teknologjistët dhe gazetarët, dhe stimulojnë ndërgjegjësimin për të drejtat e njeriut (si privatësia dhe e drejta për mosdiskriminim) dhe për etikën profesionale. Këto programe duhet gjithashtu t'i pajisin stafet me njohuritë dhe aftësitë që u nevojiten për të punuar në organizatat bashkëkohore të lajmeve dhe për t'i përgatitur ata për zhvillimet e mundshme të së ardhmes. Gjatë këtij procesi, organizatat e lajmeve duhet të shmangin teknosolucionizmin që shkon kundër vlerave dhe misionit të tyre.

**3.6.** Zhvillimi dhe zbatimi i sistemeve të IA-së në gazetari në përputhje me misionin e organizatës së lajmeve kërkon hapësirë, kohë dhe investim afatgjatë. Disa organizata lajmesh, siç janë mediat publike me burime të mira dhe mediat e mëdha, janë më në avantazh për ta ofruar këtë gjë. Në disa raste, mund të ekzistojnë mundësi për ndarjen vullnetare të kërkimit, metodave dhe praktikave më të mira. Mediat publike të financuara mirë mund të luajnë një rol të rëndësishëm pioner në zhvillimin dhe zbatimin e sistemeve të IA-së në gazetari dhe mund ta konsiderojnë këtë si pjesë të misionit të tyre publik për të mbështetur kërkimin dhe inovacionin në këtë fushë, duke ndarë përvojat, praktikat më të mira dhe teknologjinë e tyre (aty ku është e mundur) me palë të tjera të interesuara (duke përfshirë mediat e tjera) dhe duke inkurajuar debatin publik mbi rolin e inteligjencës artificiale në shoqëri. Kjo do të ndihmojë në zhvillimin e standardeve të përbashkëta për zbatimin dhe zhvillimin e përgjegjshëm të IA-së, duke forcuar qëndrueshmërinë e sektorit mediatik në përgjithësi.

## 4. Përdorimi i mjeteve të IA-së në lidhje me përdoruesit dhe shoqërinë

**4.1.** Ndërsa mediat e lajmeve gëzojnë mbrojtje të gjerë sipas Nenit 10 të Konventës, kjo mbrojtje shoqërohet me **përgjegjësi dhe detyrime ndaj qytetarëve dhe publikut në përgjithësi**. Si të drejtat ashtu edhe përgjegjësitë që rrjedhin nga kjo dispozitë shtrihen edhe mbi teknologjinë, duke përfshirë kështu detyrimin për të përdorur teknologjinë digjitale (përfshirë sistemet e IA-së në gazetari) në mënyrë të përgjegjshme dhe të sigurt, në përputhje me etikën e gazetarisë dhe me kodet profesionale, dhe në një mënyrë që nuk çënon të drejtat e njeriut.

**4.2.** Organet mediatike dhe gazetarët kanë një rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe përditësimin e rregullt të standardeve për zbatimin dhe përdorimin e përgjegjshëm të IA-së në gazetari (edhe kur përdorin teknologji të palëve të treta). Ato duhet të kenë një **vizion transparent**, të shprehur qartë, për shembull, në kode vetërregulluese dhe organizative, në deklarata misioni dhe në udhëzime të brendshme, të dala nga një dialog me aktorë të tjerë relevantë. Në mënyrë ideale, standarde të tilla do të zhvilloheshin përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt të kuptuarit se si IA mund të ndikojë në grupe të ndryshme në shoqëri dhe në interesa të ndryshme shoqërore. Këto angazhime përbëjnë gjithashtu një mundësi për mediat e lajmeve që të dallohen nga profesionet e tjera, si dhe një mjet për të qenë të përgjegjshme ndaj publikut gjatë përdorimit të sistemeve të IA-së. Mediat e lajmeve gjithashtu kanë një rol të rëndësishëm në informimin e publikut rreth IA-së dhe pasojat e saj për përdoruesit dhe për shoqërinë.

**4.3. Vlerat tradicionale të gazetarisë**, si paanshmëria, autonomia, saktësia, diversiteti, mungesa e paragjyqimeve, vërtetësia dhe objektiviteti, **mbeten po aq të rëndësishme** në kontekstin e sistemeve të IA-së në gazetari – por mund të kërkojnë riformulim ose rikonceptualizim në kontekstin e mundësive dhe rreziqeve të reja që shoqërojnë përdorimin e këtyre sistemeve. Përveç kësaj, mund të jetë e nevojshme të formulohen dhe të vihen në zbatim prioritete të reja, për shembull në lidhje me cilësinë dhe drejtësinë e të dhënave, sigurinë, si dhe mbikëqyrjen nga ekspertët.

**4.4.** Zbatimi dhe përdorimi i disa sistemeve të IA-së në gazetari mund të ndryshojë marrëdhënien me audiencën dhe duhet të nxjerrë në pah vlerat e përqendruara te publiku. Këto vlera kryesore janë transparenca dhe shpjegueshmëria (të dimë nëse, ku dhe si përdoret intelijenca artificiale ne redaksi), saktësia, privatësia dhe mbrojtja e të dhënave, aksesueshmëria, diversiteti, e drejta e anëtarëve të audiencës për të formuar mendime dhe për të marrë vendime të pavarura, aftësia për të zgjedhur mes sistemeve të ndryshme të personalizimit ose për t'i shmangur plotësisht ato, dhe e drejta për t'u informuar dhe për të vënë në pikëpyetje vendimet e automatizuara, si dhe mundësia për të shprehur shqetësime. Në rastin e prodhimit të automatizuar të përmbajtjes duke përdorur inteligjencën artificiale gjeneruese, zhvillimi i procedurave dhe masave mbrojtëse

organizative për të garantuar autenticitetin dhe saktësinë, mbikëqyrja njerëzore e përmbajtjes së gjeneruar automatikisht, si dhe respektimi i privatësisë dhe konfidencialitetit të ndërveprimeve si të audiencës ashtu edhe të subjekteve me sistemin, mund të jenë veçanërisht të rëndësishme për besimin e publikut të lajmet.

**4.5.** Për sa kohë rekomandimet, përmbajtja, modelet e shpërndarjes ose çmimet janë të **personalizuara**, subjektet duhet të kenë të drejtën për personalizim të përgjegjshëm. Kjo nënkupton marrjen e informacionit dhe zgjedhjeve të nevojshme për të qenë në gjendje të ushtrojnë kontroll mbi të dhënat e tyre personale, të kenë mundësinë të menaxhojnë dhe të rregullojnë profilet e tyre, t'u ofrohet një zgjedhje reale midis cilësimeve të ndryshme të personalizimit që marrin parasysh interesat afatshkurtra dhe afatgjata, përfshirë edhe mundësinë për të mos marrë fare rekomandime dhe oferta ose çmime të personalizuara, si dhe t'u ofrohet mundësia për të shprehur shqetësime dhe kritika që reflektohen në implementimet e ardhshme. Përveç kësaj, përdoruesve duhet t'u rikujtohet rregullisht se disa shërbime të lajmeve janë të personalizuara, sesi dhe pse është bërë kjo gjë, si dhe sesi kjo mund të zhbëhet duke ndryshuar cilësimet.

**4.6.** Një element i rëndësishëm i përdorimit të përgjegjshëm të sistemeve të IA-së në gazetari është përkthimi i vlerave editoriale në dizajnin e algoritmeve. **Proceset e dizajnit të bazuar në vlera** mund të jenë të gjata, të ndërlikuara dhe që kërkojnë ekspertizë multidisiplinare. Shumë vlera nuk janë absolute, por kërkojnë kompromise me vlera dhe shqetësime të tjera, ose nuk mund të përkthehen lehtësisht në kod. Një proces i tillë shpesh kërkon edhe kombinimin e ekspertizave të ndryshme, si ajo teknologjike, por edhe ligjore, etike ose gazetareske. Kur organizatat e lajmeve mbështeten në sistemet gazetareske të IA-së të ofruesve të teknologjisë, vendimi i prokurimit duhet të marrë parasysh vlerat për të cilat këto sisteme janë optimizuar, si dhe t'i nënshtrohet vlerësimit të rrezikut të përmendur në paragrafin 1.4 dhe kërkesave për transparencë të përmendura në paragrafin 3.4.

**4.7.** Zbatimi dhe përdorimi i sistemeve të IA-së në gazetari në përputhje me vlerat është një detyrë e vështirë dhe shpesh **nuk ka përgjigje të gatshme, pasi sfida e vërtetë qëndron te operacionalizimi**. Prandaj, një pjesë e përgjegjësisë editoriale të një organizate mediatike është të krijojë, aty ku është e mundur, hapësirën, kohën dhe burimet për eksperimentim dhe për përdorimin e përgjegjshëm të IA-së në gazetari. Kjo përfshin edhe dhënien e autoritetit dhe ndikimit të nevojshëm bartësit të përgjegjësisë, në mënyrë që ai/ajo të drejtojë këtë proces.

Minimalisht, ky proces përfshin:

- ▶ Një proces të dokumentuar, në nivel organizate, për identifikimin, negocimin dhe përcaktimin e vlerave thelbësore.
- ▶ Një vlerësim të vazhdueshëm të mënyrës se si funksionojnë sistemet e IA-së në gazetari, nëse ekzistojnë anëshmëri që duhen shmangur ose rreziqe dhe pasoja të tjera të paqëllimshme dhe efekte anësore që teknologjia mund të ketë mbi të drejtat e njeriut.
- ▶ Hapësirë për eksperimentim multidisiplinar, të larmishëm, ndërorganizativ, ndërprofesional dhe pjesëmarrës, si dhe për ndarjen e praktikave më të mira, brenda kufijve të fizibilitetit, veçanërisht për redaksitë më të vogla.
- ▶ Si pjesë e llogaridhënies publike, komunikim i qartë dhe transparencë e këtij procesi ndaj publikut, duke përfshirë mekanizma që u mundësojnë anëtarëve të publikut të shprehin shqetësimet e tyre dhe që këto të merren në konsideratë.
- ▶ Një rishikim të mjeteve që përdoren nga stafi editorial dhe ndarjen e përvojës dhe praktikave më të mira për përdorimin e këtyre mjeteve.

**4.8.** Zbatimi dhe përdorimi i përgjegjshëm i sistemeve të IA-së në gazetari nënkupton që jo vetëm redaktorët dhe gazetarët, por edhe ofruesit e teknologjisë që punojnë në inteligjencën artificiale gazetareske të veprojnë duke pasur parasysh vlerat profesionale, si dhe të drejtat dhe interesat e subjekteve dhe të audiencës. Për rrjedhojë, kërkohet një nivel i mjaftueshëm i njohurive mbi etikën dhe të drejtat e njeriut për të gjitha palët e përfshira.

## 5. Përgjegjësitë e ofruesve të jashtëm të teknologjisë dhe platformave

### 5.1. Ofruesit e teknologjisë (përfshirë platformat në masën që ato zhvillojnë sisteme të inteligjencës artificiale për mediat)

**5.1.1.** Rëndësia e autonomisë editoriale dhe aftësia për të vepruar në përputhje me vlerat profesionale për funksionimin demokratik të mediave nënkupton gjithashtu një detyrim për ofruesit e teknologjisë si palë të treta kur ata bashkëpunojnë me organizata mediatike, **që të respektojnë këto vlera, autonominë editoriale dhe pavarësinë e mediave.**

**5.1.2.** Ofruesit e teknologjisë duhet të pranojnë se, ndonëse automatizimi mund të ndihmojë në disa detyra të zinxhirit të prodhimit gazetaresk, **gazetarët do të kenë nevojë që disa (apo shumica) prej këtyre detyrave të kryhen nga njerëzit** – dhe ka të ngjarë të kërkojnë mbikëqyrje nga ekspertë të të gjithë zinxhirit të prodhimit. Për më tepër, ka të ngjarë që jo të gjithë përdoruesit të kenë aftësi të forta teknike, dhe disa do të kenë nevojë për udhëzime të qarta dhe të kuptueshme se si funksionojnë mjetet dhe si të përdoren ato.

**5.1.3.** Ofruesit e teknologjisë duhet gjithashtu të kuptojnë disa nga **rreziqet unike ose të shtuara me të cilat përballen mediat** në lidhje me mënyrën se si interpretohet prodhimi i tyre, rreziqe të cilat mund të përfshijnë shqyrtim të rreptë publik, standarde të larta etike, tolerancë të ulët ndaj gabimeve, pasoja ligjore, si dhe nivele të larta presioni politik dhe ekonomik.

**5.1.4.** Ofruesit e teknologjisë mund të marrin gjithashtu në konsideratë, aty ku kjo është e mundur nga pikëpamja komerciale, **vënien në dispozicion** të disa prej modeleve të tyre, të dhënave të trajnimit dhe burimeve të tjera **për redaksitë** që synojnë të zhvillojnë sistemet e tyre të inteligjencës artificiale për gazetari.

**5.1.5.** Ofruesit e teknologjisë duhet të pranojnë se **organet mediatike ndryshojnë** shumë për nga madhësia dhe se organizatat më të vogla mund të mos jenë realisht në gjendje të gjenerojnë mjaftueshëm të dhëna që sistemet e tyre të IA-së për gazetari të funksionojnë në mënyrë optimale. Prandaj, ofruesit duhet, kur është e përshtatshme, të ofrojnë vlerësime transparente dhe praktike mbi mënyrën se sa mirë do të funksionojnë sistemet e tyre në shkallë të ndryshme dhe në rrethana të ndryshme.

**5.1.6.** Ofruesit e teknologjisë duhet të ndërmarrin hapa për të **siguruar paralajmërim të mjaftueshëm në kohë** dhe informacion të plotë mbi ndryshimet ose përshtatjet e produkteve, si dhe mbi ndryshimet në infrastrukturën kryesore të inteligjencës artificiale dhe në softuer. Zhvilluesit e teknologjisë duhet të pranojnë dhe të marrin parasysh faktin se edhe ndryshime të vogla ndonjëherë mund të kenë pasoja të mëdha për autonominë editoriale të organeve

mediatike, për realizimin e vlerave profesionale dhe për aftësinë e tyre për të përmbushur misionin e tyre.

**5.1.7.** Në masën që organet mediatike varen nga ofruesit e teknologjisë për të qenë në gjendje të përdorin sistemet e IA-së në gazetari në mënyrë të përgjegjshme, transparente dhe të shpjegueshme, ofruesit kanë përgjegjësinë **të ofrojnë ndihmën dhe bashkëpunimin e tyre**, për shembull duke qenë të disponueshëm për pyetje ose duke qenë transparentë, kur është e nevojshme, lidhur me modelet dhe të dhënat e përdorura. Ofruesit e teknologjisë duhet të jenë të detyruar t'u ofrojnë organeve mediatike informacion të mjaftueshëm për të lehtësuar vlerësimin e tyre të rrezikut.

## 5.2. Platformat (që shpërndajnë lajme)

**5.2.1.** Duke qenë se platformat që shpërndajnë ose ndërmjetësojnë lajme prej kohësh kanë përdorur sisteme të IA-së për të operuar në shkallë të gjerë, rekomandimet ekzistuese të Komitetit të Ministrave mbi qeverisjen e medias dhe komunikimit, pluralizmin mediatik dhe gazetarinë cilësore mbeten të zbatueshme për rolin e platformave në krijimin e kushteve për implementimin e përgjegjshëm të sistemeve të IA-së në gazetari, përfshirë edhe sistemet e përdorura nga platformat për shpërndarjen e gazetarisë.

Kjo përfshin:

- ▶ nevojën për të **zhvilluar përgjigje të përshtatshme të qeverisjes së brendshme** për të siguruar që përmbajtja të jetë universalisht e disponueshme, e lehtë për t'u gjetur dhe e njohur si një burim informacioni i besueshëm nga publiku (CM/Rec(2022)4);
- ▶ kërkesën që ato **të mos kufizojnë aksesin në lajme bazuar vetëm në opinione politike ose të tjera** (CM/Rec(2022)4);
- ▶ nevojën për të **reflektuar mbi ndikimin e tyre shoqëror** (Shënim Udhëzues mbi Prioritizimin e Përmbajtjes me Interes Publik Online);
- ▶ **shmangien e ndërhyrjes në përmbajtjen e lajmeve dhe shmangien e mbivendosjes së standardeve editoriale** (CM/Rec(2022)11), si dhe nevojën **për të bashkëpunuar me redaksitë e lajmeve, shoqërinë civile dhe palë të tjera te interesuara si verifikuesit e fakteve** në luftimin e dezinformimit dhe keqinformimit (CM/Rec(2022)4);
- ▶ **fuqizimin e përdoruesve** duke ofruar si mundësinë për të hequr dorë nga personalizimi i lajmeve, ashtu edhe forma alternative të personalizimit (CM/Rec(2022)11);
- ▶ sigurimin që **anëshmëria algoritmike të mos shkelë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore** (CM/Rec(2022)11);

► **rritjen e transparencës, llogaridhënies, shpjegueshmërisë dhe inkluzivitetit të sistemeve të përdorura për personalizimin e shpërndarjes së përmbajtjes së lajmeve, duke ofruar njëkohësisht informacion mbi përdorimin, natyrën, qëllimin dhe funksionalitetin e tyre (CM/Rec(2022)11).**

## 6. Detyrimet e Shteteve

**6.1.** Shtetet kanë një detyrim pozitiv për të mbrojtur dhe krijuar kushte të favorshme për realizimin e të drejtave të njeriut dhe pluralizmit mediatik. Ekziston nevoja **për diversifikimin e skemave të financimit** për të mbështetur projekte afatshkurtra dhe afatgjata mbi zhvillimin e sistemeve të përgjegjshme të inteligjencës artificiale në gazetari, si dhe, më gjerësisht, mjete dixhitale alternative dhe infrastruktura komunikimi, veçanërisht për organizatat mediatike më të vogla dhe lokale. Megjithatë, skema të tilla nuk duhet të komprometojnë pavarësinë e gazetarisë. Nisma të mundshme mund të përfshijnë fonde për kërkim dhe zhvillim në mediat që veprojnë në interesin publik, të kombinuara me detyrimin për të investuar në inovacionin e mediave dixhitale dhe për t'i vënë mjetet dhe aplikacionet e përfutuara në dispozicion si burim i hapur; krijimin e programeve të dedikuara të financimit; ose nxitjen dhe lehtësimin e bashkëpunimit ndërmjet akademisë, komunitetit teknik dhe mediave. Shtetet duhet të ndër marrin hapa efektivë për zbatimin e Rekomandimit CM/Rec (2022)4.

**6.2.** Shtetet kanë një rol të rëndësishëm për të nxitur **aksesin dhe zgjedhjen midis ofruesve të teknologjisë** që respektojnë dhe promovojnë realizimin e vlerave gazetareske dhe të drejtave të njeriut. Për këtë qëllim, shtetet duhet të krijojnë kushte të favorshme për zgjidhjet me burim të hapur (*open-source*), për aksesin në të dhënat e trajnimit, për qasje në të dhëna të hapura, si dhe për të siguruar konkurrencën ndërmjet ofruesve të teknologjisë, përfshirë ndërmarrjet evropiane dhe start-up-et e specializuara, duke respektuar njëkohësisht të drejtat e të tjerëve.

**6.3.** Shtetet duhet të inkurajojnë autoritetet rregullatore të pavarura, ose organet vetërregulluese të mediave, që të ndihmojnë në **zhvillimin e udhëzimeve dhe standardeve** për përdorimin dhe zhvillimin e përgjegjshëm të IA-së në gazetari, në përputhje me Udhëzimet ekzistuese. Kjo duhet të përfshijë gjithashtu sqarimin e statusit ligjor të të dhënave të trajnimit; standardet e praktikave të mira të nxjerrjes së drejtë të të dhënave dhe të atribuimit dhe etiketimit të përmbajtjes sintetike; standardet e praktikave të mira për transparencën dhe mbikëqyrjen njerëzore; si dhe situatat në të cilat përdorimi i IA-së (gjeneruese) rrezikon të bjerë ndesh me të drejtat e njeriut dhe vlerat publike. Një fokus i veçantë duhet të jetë në ndihmën për përkthimin e standardeve abstrakte në masa konkrete, për shembull përmes mbledhjes së shembujve të praktikave më të mira ose krijimit të hapësirave të sigurta për eksperimentim. Organet (vetë)rregulluese gjithashtu mund të kryejnë ose lehtësojnë kërkime afatgjata mbi efektet e sistemeve të IA-së gazetareske në gazetari dhe shoqëri në kombinim me palët e tjera të interesuara. Organet (vetë)rregulluese mund të lehtësojnë gjithashtu bashkëpunimin dhe shkëmbimin e praktikave më të mira ndërmjet aktorëve përkatës, përfshirë zhvilluesit e teknologjisë, platformat, gazetarët, akademinë dhe shoqërinë civile, si dhe grupet dhe aktorët e ndryshëm shoqërorë, për të siguruar që praktikat e reja të shqyrtohen nga një shumëllojshmëri perspektivash dhe që çdo udhëzim të përditësohet duke i reflektuar zhvillimet e reja.

**6.4.** Shtetet duhet të inkurajojnë autoritetet rregullatore të pavarura, organet vetërregulluese të mediave ose organet e përcaktimit të standardeve që **të ndihmojnë organet mediatike në hartimin e udhëzimeve për prokurimin**, duke vënë në dispozicion klauzola standarde për prokurimin e përgjegjshëm të sistemeve të IA-së në gazetari. Kjo mund të ndihmojë organizatat e mediave më të vogla dhe lokale dhe të forcojë fuqinë e tyre negociuese kundrejt ofruesve të teknologjisë, duke ndihmuar kështu në vendosjen e një standardi të përgjithshëm për zhvillimin e inteligjencës artificiale gazetareske të përgjegjshme. Udhëzimet për prokurimin e përgjegjshëm të inteligjencës artificiale duhet të jenë rezultat i një dialogu midis organizatave të lajmeve dhe ofruesve të inteligjencës artificiale gazetareske.

**6.5.** Rregullatorët e pavarur dhe të përgjegjshëm kanë një rol për të krijuar kushtet për shqyrtimin kritik të drejtësisë së marrëdhënieve tregtare dhe marrëveshjeve kontraktuale midis organizatave mediatike, platformave dhe ofruesve të teknologjisë, me vëmendje të veçantë në **adresimin e çekuilibrave të mundshëm të fuqisë negociuese** në rastin e organizatave mediatike më të vogla ose lokale.

**6.6.** Organet (vetë)rregulluese mund të **mbështesin transparencën dhe llogaridhënien** duke lehtësuar raportimin e pavarur, për të mundësuar shqyrtimin publik të përdorimit të IA-së në gazetari, si dhe duke hulumtuar qëndrimet dhe nivelin e kuptimit të publikut ndaj këtyre çështjeve dhe praktikave. Në disa raste, kur rregullatorët kanë kompetenca ekzistuese për të mbledhur informacione nga platformat rreth sistemeve dhe proceseve të tyre, kjo mbledhje informacioni mund të shërbejë për të realizuar raportime të tilla, si dhe të kontribuojë në hartimin e udhëzimeve dhe standardeve të përbashkëta.

**6.7.** Shtetet duhet të ndërmarrin nisma në bashkëpunim me organizatat mediatike, gazetarët, platformat, studiuesit e komunikimit dhe OJQ-të përkatëse, të konceptuara **për të rritur aftësitë e qytetarëve në fushën e të dhënave, medias dhe inteligjencës artificiale**, në mënyrë që ata të jenë më të aftë të kuptojnë përdorimin e sistemeve të inteligjencës artificiale në gazetari nga mediat dhe të shfrytëzojnë më mirë kontrollin mbi personalizimin që ofrojnë organizatat dhe platformat e lajmeve. Nxitja e edukimit mbi IA-në është një proces i vazhdueshëm që duhet t'i përgjigjet zhvillimeve teknologjike dhe fazave të ndryshme të jetës së njerëzve në mënyrë që ata të jenë më të aftë të kuptojnë përdorimin e sistemeve gazetareske të IA-së si dhe të shfrytëzojnë më mirë kontrollin mbi personalizimin që ofrojnë organizatat e lajmeve dhe platformat.